Kerkesat me te medha perfshijne kryesisht zonen verilindore dhe jug lindore qe perbejne dhe zonat me konsumin me te ulet te energjise elektrike.

5. Problematikat e hasura nga lidhja e HEC-ve ne rrjetin e shperndarjes

- 5.1 Kerkesat per gjeneruesit e lidhur direkt me sistemin e shperndarjes sipas Kodit te Shperndarjes
 - II.7.1 Kodi i Shperndarjes aplikohet per te gjithe Gjeneruesit egzistues, ose te ardhshem, te Lidhur direkt me Sistemin e Shperndarjes, perfshire Gjeneruesit me Ko-ogjenerim, Gjeneruesit me Vete-prodhim si dhe Gjeneruesit qe perdonin burime te rinovueshme te energjise elektrike.
 - II.7.2 Perdoruesit me gjenerator "stand-by"(ne gatishmeri) qe jane te lidhur me Sistemin e Shperndarjes, duhet te plotesojne kerkesat e OSSH duke shmangur operimin ne paralel me rrjetin. Keto kerkesa përskruhen ne Marreveshjen e Lidhjes. Gjeneruesit e lidhur direkt me Sistemin e Shperndarjes do te nisin diskutimet ne një stad te hershem te planifikimit, per te lejuar OSSH-ën qe te shqyrtoje ndikimin e Njesise Gjeneruese mbi Sistemin e Shperndarjes.
 - II.7.3 OSSH mund te refuzoje lejen per lidhjen e Njesise Gjeneruese ne një pike te Sistemit te Shperndarjes, ose te kërkoje rishikim te parametrave te ndertimit ose parametrave teknike te njesise gjeneruese, ose te vendose disa kufizime me qellim qe te garantoje ruajtjen e sigurise dhe cilesine e standarteve te furnizimit. Ne kete rast, OSSH do te siguroje informacion te mjaftueshem shpjegues per te justifikuar refuzimin ose rishikimet e kerkuara. Te gjithe Gjeneruesit e lidhur direkt me Sistemin e Shperndarjes do ti sigurojne OSSH te gjitha te dhenat dhe informacionin e kerkuar nga OSSH-ja sipas afateve te percaktuara ne kete Kod Shperndarje.

IV.3.7.6 Çrregullimet e Tensionit

- IV.3.7.6.1 Perdoruesve te Sistemit te Shperndarjes nuk ju lejohet te shkaktojne luhatje ne nivelin e tensionit pertej kufijve te lejuar, per te mos ndikuar ne Perdoruesit e tjere te lidhur ne Sistemin e Shperndarjes. Perdoruesit duhet te zgjedhin pajisjet te cilat jane ne gjendje te funksionojne ne menyre normale brenda kufijve te lejuar te luhatjeve te tensionit sipas standarteve te njoitura nderkombetare.

Ne baze te Kodit te Shperndarjes kufijte e tensionit gjate operimit jepet ne tabelen e mëposhtme:

Tab. 15 Kufijte e Tensionit gjate Operimi

Tensioni nominal	Tensioni me i ulet	Tensioni me i larte
230 v	- 10 %	+ 5%
400 v	- 10%	+ 5%
10 000 v	- 5%	+ 5%
20 000 v	- 5%	+ 5%
35 000 v	- 5%	+ 5%
110 000 v	- 5%	+ 5%

Rrjeti shpërndarës ku janë lidhur HEC-et e vegjël ka tregues performance të përkeqësuar, kjo nën ndikimin e faktorëve të ndryshëm në vecanti rrjedhojë e pozicionit gjeografik ku janë ndërtuar HEC-et e vegjël të cilat janë zona të thella rurale.

- Gjendja e amortizuar e fidrave.
- Janë fidra ajrore, radiale pa mundësi rezervimi apo alternative furnizimi nga fidra të tjera.
- Zonat ku kalon rrjeti i përkasin zonave të thella rurale.
- Mungesa e investimeve për një kohë të gjatë, shpesh ka degëzime të fidrave të sajuara nga vetë banorët.
- Kalojnë në zona ku ka ulje të konsumit të energjisë elektrike për shkak të lëvizjes së popullsisë vitet e fundit drejt zonave të banuara dhe si të tilla nuk janë planifikuar investime në planin afatshkurtër.
- Zonat ku kalojnë në përgjithësi janë zona malore dhe linjat janë të ekpozuara në erë të fortë, reshje shiu e bore, temperatura të ulëta, kushte këto që provokojnë difekte në rrjet.
- Mungesa e infrastrukturës rrugore në këto zona rrit kohën për lokalizimin dhe riparimin e difekteve.
- Efektet negative të mbitensionit, mbingarkesës në rrjet për shkak të prodhimit si dhe provokim i stakimeve nga rritja e prodhimit në periudhën me reshje.
- Mungesa e dispecerisë për HEC-et e vegjël ndikon direkt në vonesën në kohë të zbatimit të urdhërave të dhënë për veprime operative, manovrime sipas normave teknike specifike dhe rregullave të sigurisë.

Më sipër kemi përmendur se rritja e numrit dhe fuqisë së instaluar të HEC-eve lokale në rrjetin shpërndarës të OSHEE është shoqëruar me disa shqetësime/probleme teknike dhe financiare të cilat kanë ndikuar në uljen e sigurisë së furnizimit me energji elektrike të rrjetit tonë shpërndarës.

Nga ana jonë janë analizuar zonat energjitike të kthyera në nyje problematike, shkaktuar si rezultat i rritjes së prodhimit të energjisë elektrike nga HEC-et dhe janë dhënë opinione për zgjidhjen e tyre.

Ndër problemet/shqetësimet kryesore mund të theksojmë:

- **Rritja e humbjeve teknike të energjisë aktive** në rrjetat shpërndarëse të kompanisë OSHEE sh.a. si rezultat i rritjes së ngarkesës për efekt të prodhimit të injektuar nga HEC-et lokale, fenomen i vërejtur kryesisht në rajonin Ersekë – Leskovik, Vlorë, Kukës, Mirditë, Bulqizë, Skrapar, Korçë, Prenjas, Corovodë etj.

- **Rritja e nivelit të tensionit në rrjetat shpërndarëse mbi kufirin maksimal të lejuar për efekt të rritjes së energjisë reaktive të injektuar në rrjet nga HEC-et lokale dhe kërkesës së ulët të rrjetit shpërndarës për energji reaktive, fenomen i vërejtur kryesisht në rajonet shpërndarës të Kukësit, Skraparit, Bulqizës, Prenjas, Ersekë, Corovodë, Cerrik, Kuc, Reps etj. Rritja e nivelit të tensionit në këto zona ka cuar në dëmtim të paisjeve në nënstacionet Ersekë, Kukës, Prenjas. Në nënstacion Kukës u dëmtua transformatori I fuqisë 20MVA 110/35/6kV, në nënstacion Ersekë u dëmtua impianti 10kV.**
- **Rritja e ngarkesave në linjat dhe transformatorët e fuqisë të nënstacioneve.** Ka pasur raste ku fuqia e emetuar nga prodhimi i HEC-eve kalon kapacitetin e fuqisë së instaluar në nënstacione, apo kapacitetin transmetues të linajve 35kV. Në këto kushte është kufizuar prodhimi i energjisë nga HEC-et si në zonën e Lozhanit/Korcë, Ersekë/Korcë, Corovodë/Berat, Bulqizë/Burrel.
- **Rritja e fuqisë prodhuese mbi atë të aprovuar në miratimin e pikës së lidhjes, shoqërohet me veshtrësi në shfaqjen e mbingarkesave në linja dhe transformatorë fuqie gjë që bëhet shpesh burim konflikti midis OSHEE dhe prodhuesve.**
- **Kontrata tip parashikonblerjen e energjisë në zbarat e tensionit të mesëm të HEC-it, fenomen i cili është i shoqëruar me mbulimin e humbjeve në rrjet artificialisht nga ana e OSHEE, këto humbje në funksion të sasisë së prodhuan të energjisë nga HEC-et si dhe cmimit të blerjes mund të shkojnë në vleftën deri 1,000,000 euro në vit.**
- **OSHEE nuk ka të dhëna ditore online mbi prodhimin e HEC-eve lokale, të dhëna të cilat OST sh.a. i mundëson për energjinë e transmetuar nga ana e saj.**
- **Fluksi i energjisë që emetohet në rrjet nga HEC-et lokale të rinj kërkon shpesh rikonstruksion të rrjetit shpërndarës në linja dhe paisje të tensionit të lartë, investim i cili shpesh krijon konflikt midis palëve.**
- **OSHEE nuk ka pasur informacion të plotë për lejet koncesionare të dhëna të HEC-eve të rinj dhe zonën ku ato janë parashikuar për tu ndërtuar, opinionin paraprak të lidhjes me rrjetin shpërndarës, gjë e cila e vë para vështirësive për dhënien/miratimin e pikës së lidhjes me rrjetin shpërndarës të OSHEE.**
- **OSHEE nuk ka informacion për koncessionet që janë në fazë ndërtimi.** Këto Koncensione paraqiten për pikë lidhje tek në fazën kur kanë përfunduar ndërtimin, gjë që na vë në vështirësi për studimin dhe ofrimin e pikës së lidhjes.
- **Një pjesë e HEC-eve të lidhur në rrjetin e shpërndarjes të OSHEE (ato të lidhur kryesisht në rrjetin 35 kV) kanë vendosur paisjet e tyre brenda territorit të n/stacioneve që administrohen nga OSHEE, paisje të cilat i shërbejnë/shfrytëzohen nga HEC-et, ndërsa veprimet operative kryhen nga personeli i n/stacioneve të OSHEE.**
- **Menaxhimi i HEC-ve në fushën e dispecerimit has vështirësi për shkak të mungesës së një rregulloreje bashkeverpimi dhe mosbatimit nga ana e prodhuesve të kërkesave sipas kodit të shpërndarjes.**

Në analizen e efekteve që jep në rrjet shpërndarës lidhja e burimit të ri gjenerues në vazhdimësi janë konstatuar fenomenet e mëposhtme:

1. Mbingarkesa të rrjetit shpërndarës ku janë të lidhur H/C-et për shkak të rritjes së prodhimit.
2. Mungesa të kapaciteteve transmetuese dhe transformuese për emetimin e energjisë së HEC-eve lokale.
3. Nivele të larta tensioni mbi vlerën e lejuar në kodin e shpërndarjes ± 5%.
4. Gjendja e amortizuar e rrjetit shpërndarës 6/10/35 kV në zonat ku ndërtohen HEC-et.
5. Niveli i lartë i humbjeve të energjisë elektrike.
6. Performancë jo e mire e rrjetit shpërndarës.

Referuar problematikave të analizuara nga, OSHEE përparrë miratimit të pikës së lidhjes të HEC-eve lokale kryen modelimin e rrjetit shpërndarës/nstacionit/rajonit në të cilin propozohet miratimi i pikës së lidhjes e HEC-it.

Në modelimin e rrjetit shpërndarës përcaktohen treguesit kryesorë teknik në nyje të rrjetit shpërndarës (tensioni, humbjet teknike, ngarkesa e elementeve të skemës si linja dhe transformatorë) për skenarin më të rënduar, prodhim maksimal, energji reaktive minimale e kërkuar nga rrjeti.

Rezultatet e modelimit analizohen për të vazhduar proceduren e studimit të pikës së lidhjes me rrjetin shpërndarës.

Në disa raste për shkak të mungesës së kapaciteteve transmetuese dhe transformuese, operatorët prodhues janë orientuar për tu bashkuar si prodhues të një pellgu dhe të drejtohen për vleresim pikë lidhje me rrjetin e OST-së nëpërmjet nënstacioneve TM/110kV të ndërtuar nga bashkimi i prodhuesve të vegjël të energjisë.

Përbalja me gjendjen e amortizuar të rrjetit shpërndarës, mungesa e kapaciteteve të transmetimit, kapaciteteve të transformimit, efekti i rritjes së tensionit në nyjet e rrjetit shpërndarës i vë në vështirësi operatoret prodhues të cilët shpesh nuk gjejnë rrugën e zgjidhjes dhe frenohen në kryerjen e investimeve në fushën hidroenergjitetike.

Nga analiza e rrjetit shpërndarës në zonat ku janë të lidhur HEC-e, problematikave të mbartura në vitet e fundit si rezultat i rritjes së fluksit të energjisë së emetuar nga HEC-et e vegjël si dhe rritjes së kërkeseve në lidhjen e burimeve të reja gjeneruese, për sigurimin e funksionimit optimal dhe të sigurtë të rrjetit, sipas standardeve të këruara të emetimit të energjisë elektrike në rrjetin shpërndarës del e domosdoshme:


1. Rikonstruksioni i nënstacioneve të kthyer në nyje problematike.
2. Fuqizimi i nënstacioneve dhe linjave 35kV të cilat punojnë në regjim të mbingarkuar dhe parashikohet të lidhen burime të reja gjeneruese.
3. Rikonstruksioni dhe fuqizimi i fidrave 6/10kV ku janë lidhur burime gjeneruese.
4. Ndryshimi kontratës së blerjes së energjisë elektrike nga prodhuesit e vegjël.
5. Në procedurën e rritjes së kapacitetit prodhues të përfshihet edhe kompania OSHEE.
6. Ndërtimi i qendrës dispecer të monitorimit, kontrollit dhe operimit të HEC-eve të vegjël.
7. Në zonat problematike të kufizohet prodhimi mbi kapacitetin prodhues të aprovuar në miratimi i pikës së lidhjes.

Humbjet e fuqise aktive do te rriten ndjeshem nese rrjeti elektrik nuk i nenshtrohet rikonstruksioneve siç janë :

- rritja e kapacitet transmetues te linjave elektrike nepermjet rritjes se seksioneve te perçjellesave
- rritje te fuqise transformatorike ne nenstacionet elektrike

kurse ne rrjetat elektrike me shkalle penetrimi te burimeve hidrike mbi 10 duhet pare mundesia e ndertimit te rrjetave te reja me tension te rritur duke zevendesuar rrjetat ekzistuese 35 kV ne nivelin 110 kV me qellim jo vetem permiresimin e humbjeve te fuqise/energjise por edhe te parametrave te tjere cilesore si stabilizimi i tensionit te rrjetit elektrik brenda normave te lejuara .

Fig. 18 Humbjet e pritshme per shkak te numrit te larte te burimeve RES ne krahasim me kapacitetin prites



6. Rekomandimet nderkombetare per modifikimin e bilancit te energjise

Efekti i Gjeneruesve te Shperndares DG (Distributed Generation) në humbjet në rrjet varet shumë nga fuqja e injektuar dhe pika e lidhjes se tij në rrjet. Për më tepër, burime të përhershme gjenerimi me një korrelacion të dobët me ngarkesen e rrjetit, të tilla si turbinat me erë apo H/C-et me derivacion, mund të kenë një ndikim negativ në humbjet në rrjet. veçanërisht gjatë natës kur ka kërkesa të ulëta per energji elektrike dhe kur energjia e prodhuar nga burimet DG eshte ne pikun e tij e favorizuar nga kushtet e motit si shpejtesia e eres apo prurjet ujore , rrjeti ne keto kushte mund të fillojë të eksportojë energji (reverse power flow) gjë që rrit humbjet në rrjet.

Shume kompani shperndarese po rishikojne metodologjine e percaktimit te humbjeve per te vene ne pah ndikimin e burimeve RES, pasi metodat tradicionale te hartimit te balance energjitike shpesha cojne ose ne vlera teper te larta te humbjeve dhe ne disa raste ne vlera negative te humbjeve.

Sipas raportit mbi Humbjet e Energjisë nga Këshilli i Rregullatorëve Evropianë të Energjisë (CEER) i botuar në vitin 2020 thotë se ka përkufizime të ndryshme të humbjeve të energjisë në të gjithë Evropën meqithate shume ente rregullatore te energjise ne Europe perfshire entin ARERA ne Itali synon të rishikojë faktorin standard të humbjeve duke marrë dhe ndikimin e gjenerimit të shpërndarë. Hungaria planifikon të zhvillojë një metodologji të re për vlerësimin e nivelit të humbjeve teknike në rrjetin e shpërndarjes për shkak të depërtimit në rritje të centraleve diellore.

Ne studimin e fundit te hartuar nga USAID me teme: "*South East European Distribution Systems Operators Support to SEE DSO in Preparation for Network Loss Reduction Strategies*" propozohet një menyre e re e hartimit te bilancit nepermjet metodes aktuale neto por asaj bruto.

Kjo menyre eshte prezantuar nga konsulentet kroate EIHP ne takimin e 23 tetorit 2017 me teme "Network Loss Reduction Study" me perfaqesues te kompanive shperndarese te ballkanit perendimor.

Kjo metode ve me ne pah efektin ne humbjet e energjise se injektuar ne rrjet nga burimet e rinovueshme te energjise te lidhur ne rrjetat shperndarese.

Ne studimin e USAID prezantohet rasti i DSO Spanjolle mbi arsyen e prezantimit te kesaj metode.

Viesgo, një OSSH spanjolle, në bashkëpunim me një prodhues elektrik, ABB, kreu një studim për të marrë një kuptim më të thellë të situatës aktuale, e cila u përjetua nga kjo OSSH për shkak të një sasie masive të gjenerimit të shpërndarë të lidhur në rrjetin e saj.


Figura e mëposhtme tregon se nga viti 1998 deri në vitin 2014, Viesgo po përjetonte midis 2.57 (2014) dhe 4.72 (2002) herë me teper se mesatarja vjetore e raportit të energjisë së rinovueshme të lidhur me rrjetin ndaj konsumit gjatë orës së pikut krasuar me të njëjtin raport mesatar të vërejtur për OSSh-të spanjolle.

Fig. 19 Energjia e rinovueshme e lidhur me rrjetin kundrejt konsumit në orën e pikut (Viesgo)



Rezultatet e marra nga Viesgo dhe ABB u gjetën duke vëzhguar humbjet në lidhje me sasinë e gjenerimit të shpërndarë në çdo zonë dhe çdo rast, siç shihet në figurën e mësipërme.

Fig. 20 Raporti Humbje kundrejt Prodhimit te impianteve te Energjise se Rinovueshme (Viesgo)



Mund të vërehet se rritja e prodhimit të burimeve të rinovueshme në skenarë me nivele të ulëta të penetrimit të DG ka një ndikim pothuajse të rëndësishëm në nivelin e humbjeve të rrjetit. Nga ana tjetër, një rritje e gjenerimit të burimeve të rinovueshme në skenarë me nivele të larta të depërtimit të DG, ka një ndikim mjaft domethënës dhe relevant në nivelin e humbjeve në rrjet.

Ekzistenza e flukseve neto të energjisë së eksportuar (jashtë rrjetit të Viesgo) lejon që niveli i humbjeve të jetë ndërmjet 2% dhe 4% dhe mungesa e kësaj gjendje (ekzistenza e energjisë së eksportuar) bën që niveli i humbjeve të jetë mbi 4%, dhe në raste ekstreme, të arrijë gati 20%.

Si rezultat i studimit, Viesgo dhe ABB i propozuan NRA-s spanjolle dhe Ministrisë së Energjisë që të rishikojnë stimujt e llogaritjes së humbjeve në rrjet dhe të marrin në konsideratë efektet e burimeve të rinovueshme në humbje që nuk janë marrë plotësisht në konsideratë në legjislacionin aktual. Propozimi i tyre është ilustruar në figurën më poshtë.

Fig. 21 Metodologjia aktuale per Humbjet ne rrjet dhe ajo e propozuar (Viesgo)

1 Current Grid Losses Methodology			2 New Methodology Proposal (Viesgo)		
$\text{Losses} = \sum \text{Borders} - \sum \text{Demand}$			$\text{Losses} = \sum \text{Borders} - \sum \text{Demand}$		
$\% \text{ Losses} = \text{Losses} / \sum \text{Losses}$			$\% \text{ Losses} = \text{Losses} / (\sum \text{Borders} + \sum \text{Borders (OUT)})$		
ENERGY BALANCE EXAMPLE					
GWh	IN	OUT	NET		
DSO-TSO	115	400	-285		
DSO-DSO	400	850	-450		
GENERATION	500	0	500		
WIND-DSO	2,255		2,255		
TOTAL BORDERS	3,270	1,250	2,020		
CUSTOMERS					
LOSSSES	1,850	-1,850			
	170				
% Losses			8.42%		5.20%

Rezultati i mesiperm pasqyron ndikimin e hyrjeve dhe daljeve të ndryshme të energjisë përmes kufijve të rrjetit (të përcaktuara si ndërlidhje me aktorët e sistemit dhe përfshin klientët, OST-të, OSSh-të dhe objektet e gjenerimit). Rezultati i kësaj është një shtrembërim i llogaritjes së humbjeve në rrjet të përdorura në stimujt e OSSH-së.

Ne materialin e USAID theksohet se kur entet rregullatore marrin parasysh stimujt për të reduktuar humbjet e rrjetit në shpërndarje, duhet të merret parasysh mënyra se si llogaritet përqindja e humbjeve në rrjet për të shmangur efektin e energjisë së injektuar në rrjet nga gjenerimi i shpërndarë. Qëllimi këtu është parandalimi i një situate ku transmetimi i energjisë në rrjetet e tensionit më të lartë penalizon tej mase shpërndarësit në zonat me kërkësë më të ulët. Sigurisht, ky ndryshim nuk e zgjidh problemin në mënyrë të përsosur. Një vlerësim individual i bazuar në modelet e rrjetit dhe flukset e energjisë është skenari i dëshiruar dhe duhet të zbatohet për të gjitha OSSH-të në mënyrë që të kemi një analizë homogjene.

6.1 Bilanci sipas metodes gross

Humbjet totale në rrjetin e shpërndarjes janë llogaritur sipas mënyrës konvencionale të aplikuar nga shumica e vendeve të Evropës Juglindore. Me futjen e gjenerimit të BRE-ve, rrjetet e shpërndarjes po shndërrohen nga rrjete pasive në ato aktive, siç është rasti i rrjetit të shpërndarjes që menaxhohet nga OSSH. Energjia e gjeneruar në disa zona të rrjetit të shpërndarjes tejkalon disa herë energjinë e konsumuar dhe një pjesë e madhe e saj kalon edhe në rrjetin e transmetimit.

- Referuar analizave dhe rekomandimeve të paraqitura në raportet e USAID dhe CEER, propozimi i parë ka të bëjë me metodën e përcaktimit të humbjeve relative.

Humbjet e reja relative nuk duhet të përcaktohen nga energjia neto, por duke marrë parasysh energjinë bruto me formulën e mëposhtme:

$$humbjet(\%) = \frac{En\ hyrese - En\ dalese}{En\ hyrese} = \frac{(En\ Import + En\ Injektuar) - (En\ Eksport + Shitjet)}{(En\ Import + En\ Injektuar)}$$

Formula e mësipërme duhet të zbatohet jo vetëm në llogaritjen e humbjeve totale, por në bilancet përkatëse të humbjeve në rrjetin e tensionit të lartë dhe humbjeve totale të ushqyesve për rrjetin TM dhe TU.

Nga analiza e bilancit individual për çdo rajon të tensionit të lartë janë vënë re dy raste specifike:


1. Humbje relative jashtëzakonisht të larta mbi 10%
2. Vlera totale negative ku vlera e kolonës së shumës së ushqyesve është më e lartë se ajo e energjisë hyrëse.

Referuar pikës nr.1, këto vlera të larta rezultojnë në ato raste specifike kur fiderat TM janë të lidhur me burimet gjeneruese (RES) por jo në zbarrat e nënstacionit. Energjia e këtyre burimeve gjeneruese zbritet nga sasia totale e konsumit të furnizuesit.

Në këto raste propozohet që energjia e këtyre ushqyesve të mblidhet në anën e energjisë hyrëse, kështu që formula e llogaritjes është si më poshtë:

$$losses (\%) = \frac{E_{in} - E_{out}}{E_{in}} \times 100\% = \frac{(E_{OST+} - E_{OST-} + E_{RES_{kV}}) - (E_{\sum \text{feeders}} - E_{RES \text{ to feeders}})}{(E_{OST+} - E_{OST-} + E_{BRE-E35kV})} \times 100\%$$

Fig. 22 SLD i një rasti të veçantë të llogaritjes së humbjeve në rrjetin HV



Pra, ndryshimet e propozuara shfaqen në kalimin e energjisë së prodhuar nga BRE të lidhura me fiderat TM por edhe të energjisë shtesë që kalon në rrjetin OST, kështu që humbjet relative të energjisë do të përcaktohen në raport me energjinë bruto.

Rasti nr.2 është nënçështje e rastit të treguar më sipër, por me ndryshimin që në këtë rast energjia mujore e prodhuar nga BRE-të lokale tejkalon energjinë e konsumuar nga furnizuesit dhe e eksporton pjesën më të madhe të saj në rrjetin OST duke rezultuar në një energji shumë të vogël të ofruar nëpërmjet rrjetit OST.

Bilanci i llogaritur në mënyrën aktuale rezulton se të dyja anët e kolonës rezultojnë në vlera negative dhe vlera relative nuk vjen në vlerën më të lartë që në këtë rast rezulton në kolonën e konsumit por në energjinë hyrëse.

Tab. 16 Bilanci Energjise sipas menyres aktuale

HUMBJET E ENERGJISE SIPAS PIKAVE TE MATJES NJTL ELBASAN					MARS 2019	
Pikat e matjes me OST dhe HEC	Detaje	Energjia sipas mafesave te OST	Shuma (Fid+NV+K35) (kWh)	Humbjet (kWh)	Humbjet %	Nenstacionet 35 kV qe furnizohen nga pikat e matjes 110 kV
ERSEKE-T1/890	detaje	2,281	(442,375)			N/st Erseke
ERSEKE-T1/890(-)	detaje	3,681,087	(933,444)			N/st Mollas
Hec Treska 4	detaje	1,733,200				Hyrje H/C10KV(-)
Hec TRESKA E RE 5	detaje	450,409				
Hec Treska 3	detaje	224,280				
Total Erseke	total	(1,270,918)	(1,375,819)	104,901	-8.25%	

Edhe në këtë rast, kryerja e bilancit në mënyrën e mësipërme do të sjellë që vlerat e të dyja palëve të janë pozitive, të njëjtat vlera të humbjeve pozitive por humbje relative në vlerë pozitive dhe të reduktuara brenda vlerave të pranueshme.

7. Sfidat e se ardhmes

Sic theksohet ne studimin e USAID hartimi i bilancit sipas metodes bruto vetem normalizon vlerat e tij brenda arsyetimit logjik por nuk parandalon efektin e burimeve te rinovueshme ne rrjetin e shperndarjes.

Operatori i shpërndarjes po përballet me kërkesa të larta për lidhjen e burimeve të BRE-ve në rrjetin e shpërndarjes për shkak të politikave favorizuese në Shqipëri dhe objektivit të diversifikimit të burimeve gjeneruese në vend por edhe funksionit për të qenë anëtar i EnC.

Por ky objektiv madhor i vendit e gjen operatorin e shpërndarjes në kushtet e një stabiliteti ende të brishtë të treguesve makro teknikë dhe financiarë.

Në aspektin teknik, rrjeti i shpërndarjes, pavarësisht investimeve të mëdha të kryera, konsiderohet ende një rrjet i vjetër, i amortizuar dhe funksionon pothuajse tërësisht manual.

Nga analiza e studimeve të vlerësuara të paraqitura në referencë dhe krahasimi me situatën aktuale të OSSH në lidhje me menaxhimin e burimeve të BRE në rrjetin e saj, disa nga problemet teknike të saj korrespondojnë me ato të përjetuara gjatë viteve 2010-2014 në rrjetet e shpërndarjes së vendet më të zhvilluara kryesisht në BE me penetrim të lartë të burimeve të BRE.

OSSH megjithë përmirësimet e ndjeshme në rrinovimin e rrjetit të saj, veçanërisht gjatë 5 viteve të fundit, sërisht rrjeti i saj në pjesën më të madhe të tij, kryesisht në zonat rurale dhe të thella rurale është i vjetër dhe i amortizuar. Lidhja dhe funksionimi i burimeve të reja të BRE-ve në shumë raste ka çuar në përkeqësimin e treguesve të sigurisë dhe cilësisë së energjisë elektrike dhe në rritjen e kostove të mirëmbajtjes dhe funksionimit.

Rrjeti i OSSH është nën presion të madh ku përveç zgjidhjes së pengesave në rrjetin e tij ku janë të lidhura burimet, HEC-et do të duhet të menaxhojnë lidhjen e burimeve kryesisht nga dielli i përqendruar në pjesën perëndimore të vendit. Veçanërisht sfidues mbetet menaxhimi i lidhjes FV për shkak të matjes neto deri në 500 kW që pritet të ndikojë në rrjetin TU ku janë të lidhur konsumatorët familjarë por edhe një pjesë të rrjeteve TM në të cilat janë të lidhura nderrmarrjet e vogla dhe te mesme.

Ne raportin e vitit 2021 me teme: Vlerësimi i Gatishmërisë për burimet e rïnovueshme (RRA) thekson veprimet kyçë për periudhën afatshkurtër dhe afatmesme që mund të krijojnë kushte më të favorshme për zhvillimin e energjisë së rïnovueshme ne Shqiperi,¹ ku nje nga aksionet kryesore permend fuqizimin e rrjetit shperndares per akomodimin e burimeve te reja RES.

Ndërsa Shqipëria shkon drejt diversifikimit te energjisë së rïnovueshme në sistemin e saj energetik rrjeti i shpërndarjes do të jetë gjithnjë e më shumë shtylla kurriore dhe faktori përcaktues i shkallës në të cilin burimet e rïnovueshme do te injektojne energji ne sistem. Gjendja aktuale e shpërndarjes rrjeti nuk është i favorshëm për rritjen e injektimi te gjenerimit të energjive të rïnovueshme variable nga dielli dhe era.

Një prioritet i menjëhershëm për OSHEE është rïnovimi i rrjetit të shpërndarjes rreth qendrat kryesore të ngarkesës së Tiranës dhe Durrësit, të cilat përbëjnë 50% të konsumit të energjisë elektrike.

Po aq i rëndësishëm është planifikimi për një rrjet aktiv që mund të lejojë rrjedhjen e energjisë elektrike në dy drejtime, akomodimi i konsumatorëve të energjisë së rïnovueshme, dhe fokusimi në përmirësimet e rrjetit afér planit zonat e prodhimit të energjisë së rïnovueshme në mënyrë që fuqia mund të evakuohen në mënyrë efektive sipas kërkesës qendrat.

Ky përmirësim duhet të përfshijë gjithashtu dispozitën të pajisjeve të reja për të garantuar sigurinë e të dhënavë, shpërndanë pajisjet e monitorimit për të mbledhurmbivendosja e sistemit të informacionit dhe komunikimit për dorëzojë të dhënët e operacioneve në OSHEE (Mantooth, 2011). Kryerja e studimeve të mëtejshme të fleksibilitetit të rrjetit, veçanërisht bazuar në zonat e energjisë së rïnovueshme dhe projektet e planikuara të gjenerimit të shpërndarë, do të udhëzonte gjithashtu rrjetin e mëtejshëm me prioritet forcimin e nevojave në përputhje me gjenerimin zgjerimi. Sipas vlerësimeve paraprake, rreth 40-80 milionë euro (48-96 milionë USD) në investime kërkohet për të rïnovuar rrjeti i shpërndarjes për të trajtuar më mirë variablin injektimi i energjisë së rïnovueshme në një afat të afërt.

¹ <https://www.irena.org/publications/2021/March/Renewables-Readiness-Assessment-Albania>